

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
INDUSTRIALE “PAVARËSIA” VLORË

Nr. 37 Prot

Vlorë , më 15.03.2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr 14 datë ,27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE “PAVARESIA “VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për 1 pozicione pune :


- Pozicioni 1.

DEGA-TERMOHIDRAULIKE PËR PERSONELIN MESIMËDHËNËS TE FORMIMIT TEORIK- PRAKTIKË PROFESIONALE (me kohë të plotë)

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë të punës si vijon:

- a)të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b)të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c)të mos jetë I dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d)të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e)të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjeljes dhe komunikimit
- f)të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit



Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës teorik-praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme ,në të njejtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.

b) të ketë të paktën 3(tre)vjet përvojë pune në fushën ,ne te cilen ka kryer studimet .

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për vendin e lirë të punës , duhet të përfshijë: -

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në);

c) kartën e identitetit;

d) diplomën;

e)- librezën e punës;

f) - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g)- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;

i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

j) - vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

3. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës , 30.03.2022

DREJTORE

ING.GENTIAN BOCI

